L I G J
Nr. 8895, datë 16.5.2002

PËR DHËNIE AMNISTIE

Në mbështetje të neneve 81 pika 1, pika 2 shkronja "ë" dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

1. Amnistohen personat e dënuar me burgim deri në 2 vjet, personat e dënuar me kusht ose me gjobë.

2. Amnistohen personat e dënuar me burgim, të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë nën moshën 18 vjeç, femrat që në datën 1 qershor 2002 kanë mbushur moshën 55 vjeç dhe meshkujt që kanë mbushur moshën 65 vjeç.

3. Amnistohen personat e dënuar me burgim ose me dënime më të buta, të cilëve në datën 1 qershor 2002 u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 2 vjet.

4. U zbriten 1/4 (përsëritësve të së njëjtës vepër penale u zbriten 1/8) e dënimit të mbetur të gjithë të dënuarve, të cilët nuk përfitojnë nga pikat e mësipërme të këtij neni.

Neni 2

Nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat e dënuar për:

a) veprat penale të parashikuara nga nenet 76, 77, 78, 79 të Kodit Penal dhe neni 77 i Kodit Penal Ushtarak;

b) veprat penale të parashikuara nga nenet 100, 101 pika 2, 102, 103 dhe 104 të Kodit Penal;

c) rrëmbim personi i parashikuar në nenin 109 të Kodit Penal;

ç) trafikim të njerëzve, shfrytëzim prostitucioni, shfrytëzim prostitucioni në rrethana rënduese, trafikim të femrave për prostitucion, të parashikuara nga nenet 110 shkronja "a", 114, 114 shkronja "a" dhe 114 shkronja "b" të Kodit Penal;

d) veprat penale të parashikuara nga nenet 136, 139, 140 dhe 141 të Kodit Penal, si dhe për vjedhje të pronës ushtarake me pasojë vdekjen e parashikuar nga neni 59 pika 2 i Kodit Penal Ushtarak;

dh) gjenocid, krime kundër njerëzimit dhe krime lufte të parashikuara nga nenet 73, 74 dhe 75 të Kodit Penal;

e) tortura me pasoja të rënda të parashikuara nga neni 87 i Kodit Penal;

ë) krime kundër pavarësisë dhe integritetit të parashikuara nga nenet 208, 209, 210, 211, 212, 217 dhe 218 të Kodit Penal;

f) krime kundër rendit kushtetues të parashikuara nga nenet 219, 220 dhe 221 të Kodit Penal.

g) krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, të parashikuara nga nenet 226, 227, 228 dhe 229 të Kodit Penal;

gj) akte terroriste të parashikura nga nenet 230 dhe 232 të Kodit Penal;

h) trafikim të armëve dhe municionit të parashikuara nga neni 278 shkronja "a" i Kodit Penal;

i) trafikim të lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe narkotike të parashikuara nga nenet 283, 284, 284 shkronja "a", 284 shkronja "c", 286 pika 2 të Kodit Penal;

Neni 3

Për efekt të zbatimit të këtij ligji, do të quhen të dënuar:

a) personat e dënuar nga gjykata e shkallës së parë dhe që brenda afatit ligjor nuk është bërë

ankim ose apel në gjykatën e apelit;

b) personat e dënuar nga gjykata e apelit.

Neni 4

Pushohen ndjekjet penale për çështjet në hetim, për çështjet e pashqyrtuara nga gjykatat, si dhe për kallëzimet që ndodhen në këto organe dhe në organet e rendit publik, për veprat penale të kryera deri në datën 1 qershor 2002, për të cilat Kodi Penal parashikon një dënim me burgim deri në 2 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë.

Neni 5

Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Mbrojtjes dhe Prokuroria e Përgjithshme për zbatimin e këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.